



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.949/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Arsim Hoxha, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.949/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Arsim Hoxha, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Qendrat e Votimit QV 2002A, QV 2007A dhe Vendvotimet VV 2002A/04R, VV 2002A/05R dhe VV 2002A/02R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.949/2021 të paraqitur nga Arsim Hoxha, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit me të cilën pretendon se në Qendrat e Votimit QV 2002A, QV 2007A dhe Vendvotimet VV 2002A/04R, VV 2002A/05R dhe VV 2002A/02R nuk është bërë numërimi real i votave, andaj ka kërkuar nga PZAP që ta urdhëroj KQZ-në që të rinumroj fletvotimet në këto Vendvotime si në apel. Në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar


Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Arsim Hoxha, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, nga Subjekti Politik LVV, dega në Komunën e Prizrenit me të cilën kërkon rinumërim të votave në Qendrat e Votimit QV 2002A, QV 2007A dhe Vendvotimet VV 2002A/04R, VV 2002A/05R dhe VV 2002A/02R është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluësës nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.949/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.